PSH.nr.1096/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "SFINGA"SHPK- PRIZREN, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "GRAFIKA SH.P.K" - Prizren lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Infografikat dhe sinjalizimi ne objektet e Administratës Komunale" me nr. të prokurimit: 622-20-6946-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK PRIZREN", më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "SFINGA"SHPK- PRIZREN, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Infografikat dhe sinjalizimi ne objektet e Administratës Komunale" me nr. të prokurimit: 622-20-6946-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK PRIZREN".

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Infografikat dhe sinjalizimi ne objektet e Administratës Komunale" me nr. të prokurimit: 622-20-6946-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK PRIZREN", dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "SFINGA"SHPK- PRIZREN, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "SFINGA"SHPK- PRIZREN, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 14.12.2020 me nr. 1096/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Infografikat dhe sinjalizimi ne objektet e Administratës Komunale" me nr. të prokurimit: 622-20-6946-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK PRIZREN", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 56 dhe 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 17.12.2020, ka autorizuar eksperten shqyrtueses të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 21.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankues Sfinga SHPK, fillimisht sqaron se, ky aktivitet i prokurimit me titull "Infografikat dhe sinjalizimi ne objektet e Administrates Komunale" inicuar nga AK-Kuvendi Komunal i Prizrenit ka hap ofertat me datë 18.11.2020 njëherit AK komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave, ka shpallur si të rekomanduar ofertuesin me çmimin më të ulët gjegjësishtë "Grafika SHPK" me datë 27.11.2020, me datë 01.12.2020 ankuesi Sfinga SHPK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek AK ku AK me datë 04.12.2020 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim meqërast Ankuesi me marrjen e vendimit nga AK, ka parashtruar ankesë në OSHP me datë 11.12.2020 **me pretendimin si në vijim:**

1. OE i rekomanduar per kontrate nuk i ploteson kerkesat per dhenie te kontrates : Ne DT kerkohet :

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar** **1.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga koha e këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Lista e projekteve te vërtetuar për tri vitet e fundit skanuar nga origjinali) për dosjen të dëshmuara me referenca të cila vlerën eupneve dhe natyrën e tyr verbal te pranimit përfundimtar të**

OE nuk ka dozuar ASNJË KONTRATE TE VETME te realizuar. OE ka dorëzuar vetëm 4 referenca / Referenca e BKT nuk ka date fare nuk dihet se cilit vit i përket , as nuk ka te specifikuar vlere te realizimit te punëve (po ashtu nuk është paraqitur as kontrata për ketë partner , e as fletëpagesa e bankës për shërbimet) Referenca FINCA , FRUTEX dhe SPAR janë te datës 13.11.2020 e cila date është pas datës se njoftimit për kontrate te kësaj procedure 29.10.2020 (Ne kërkesë FDT thuhet gjate tri viteve te fundit nga koha e këtij njoftimi)

qarkullimi i OE gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga koha e këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 80.000,00 € . Në rast të

Vlen te theksohet se as këto 3 referenca nuk kanë te paraqitur kontratat as fletëpagesat e bankës për punët e realizuar.

Nga Lista e Projekteve te realizuara asnjë projekt nuk plotëson kushtet e kërkuara – Vlerat e projekteve OE i ka plotësuar vet dhe nuk dëshmon Vlerën e projekteve te realizuar me asnjë DESHMI siç edhe e cekem me larte , janë te datës pas njoftimit për kontrate te kësaj procedure po ashtu asnjëra nga to nuk ka te paktën një natyre te shërbimeve - pajisjeve elektronike - furnizime - LED SCREEN TV DISPLAY te paktën një kontrate.

Nga e gjithë kjo konstatohet qe OE i rekomanduar për kontrate nuk i Plotëson kushtet gjë qe shume qarte shihet kur te analizohen dokumentet e kësaj procedure.

Presim nga OSHP / Eksperti dhe PSHP te Aprovoj Ankesën tone si te BAZUAR , te Urdhëroj AK Prizren te Anuloj njoftimin për Dhënie te Kontratës OE i Cili nuk i plotëson kriteret – te shpallet i papërgjegjshëm dhe gjate RI-Vlerësimit AK te na shpërbleje me KONTRATE.

Ekspertja Shqyrtuese tutje sqaron se, AK në Dosje të tenderit-njoftimi për kontratë tek Kërkesa 8.1&8.2 ka kërkuar:

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga koha e këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 80.000,00 € . Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të qrkullimit.	**Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën eupneve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të punëve.**

Gjatë vlerësimit dhe analizimit të pretendimit të OE ankuesit, **Ekspertja Shqyrtuese** konsideron se ankesa është **e bazuar**, me faktin se në ofertën e OE të rekomanduarit ekziston një listë e përshkrimit të projekteve

mirëpo nuk ka datë se kur janë përfunduar projektet, dhe po ashtu referencat nuk kanë shpjegim lidhur me datën e mbarimit të kontratës ose dëshmi më objektive, prandaj mendoj se referencat nuk janë të mjaftueshme si dëshmi/vërtetim! **(shih lartë listën tek Faktet e rëndësishme).**

Andaj konform nenit 69 të LPP-së citat:

2. Gjatë udhëheqjes së procedurave që shpien drejt dhënies së kontratës publike në të cilën përfshihet livrimin i produkteve, nga operatorët ekonomik mund të kërkohet që të dëshmojnë aftësinë e tyre teknike përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të produkteve që duhet të furnizohen:

2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

2.2. përshkrimit të pajisjeve teknike të operatorit ekonomik, masave të sigurimit të cilësisë dhe pajisjeve për zhvillim;

2.3. shënimit për përfshirjen e teknikëve dhe organeve teknike, sidomos të atyre që janë përgjegjës për kontrollimin e cilësisë;

2.4. mostrave të produktit, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive të produkteve që duhet të furnizohen; dhe/ose

2.5. certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuara që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse.

Ekspertja tutje sqaron se, nga përshkrimet më lartë mendoj se ky aktivitet i prokurimit duhet të kthehet në RIVLERËSIM, ku AK gjatë procesit të rivlerësimit të bëjë egzaminimin dhe analizmin e ofertave konform LPP-së dhe Rruopp-sè, po ashtu të konfirmohen referencat duke kërkuar AK sqarim konform nenit 72 të LPP-së, me qëllim që të vërtetohen (kontratat për projektet në fjalë ose specifikacionet/pozicionet lidhur me këto projekte të përfunduara) se a përkojnë me natyrën e projektit dhe a janë brenda afatit kohor siq kërkohet në DT.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet, njoftimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti kontraktues me datë 21.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit lidhur me kete project

.AK ne Vendimin per dhenie te kontrates I cili eshte ngritur ne platform I ka paraqite te gjitha arsyet e propozimit te shperblimit me kontrate te OE ne fjale.

Gjithashtu kemi paraqit edhe arsye e diskualifikimit te OE te cilet kan qen ose te papergjegjshem ose te pasuksesshem .

Kerkoj prej panelit shqyrtues qe edhe njeher te vlersoj kunderargumentet ton ate cilat jan pjese e vendimitn per dhenie dhe me VENDIM TA LËR NE FUQI NJOFTIMIN PER DHENIE TE AUTORITETIT KONTRAKTUES.

Operatori ekonomik me datë 28.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankues Sfinga SHPK, se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat për dhënie të kontratës pasi në dosje të tenderit kërkohet:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar** **1.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga koha e këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Lista e projekteve te vërtetuar për tri vitet e fundit skanuar nga origjinali) për dosjen të dëshmuara me referenca të cila vlerën eupneve dhe natyrën e tyr verbal te pranimit përfundimtar të**

OE nuk ka dorëzuar asnjë kontratë të vetme të realizuar. OE ka dorëzuar vetëm 4 referenca / Referenca e BKT nuk ka datë fare, nuk dihet se cilit vit i përket, as nuk ka të specifikuar vlerë të realizimit të punëve (po ashtu nuk është paraqitur as kontrata për ketë partner, e as fletëpagesa e bankës për shërbimet) Referenca FINCA , FRUTEX dhe SPAR janë te datës 13.11.2020 e cila datë është pas datës së njoftimit për kontratë të kësaj procedure 29.10.2020 (Në kërkesë FDT thuhet gjate tri viteve të fundit nga koha e këtij njoftimi)

Vlen të theksohet se as këto 3 referenca nuk kanë të paraqitur kontratat as fletëpagesat e bankës për punët e realizuar. Nga lista e projekteve të realizuara asnjë projekt nuk plotëson kushtet e kërkuara – Vlerat e

projekteve OE i ka plotësuar vet dhe nuk dëshmon vlerën e projekteve të realizuar me asnjë DESHMI siç edhe e cekem më lartë, janë të datës pas njoftimit për kontratë të kësaj procedure po ashtu asnjëra nga to nuk ka të paktën një natyrë të shërbimeve - pajisjeve elektronike - furnizime - LED SCREEN TV DISPLAY të paktën një kontratë. Nga e gjithë kjo konstatohet që OE i rekomanduar për kontrate nuk i plotëson kushtet gjë që shume qartë shihet kur të analizohen dokumentet e kësaj procedure. Presim nga OSHP / Eksperti dhe PSHP te Aprovoj Ankesën tone si te BAZUAR , te Urdhëroj AK Prizren te Anuloj njoftimin për Dhënie te Kontratës OE i Cili nuk i plotëson kriteret – te shpallet i papërgjegjshëm dhe gjate RI-Vlerësimit AK te na shpërbleje me KONTRATE.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, sqaron se AK në dosje të tenderit-njoftimi për kontratë tek Kërkesa 8.1&8.2 ka kërkuar:

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga koha e këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 80.000,00 € . Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të qrkullimit.	**Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën eupneve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të punëve.**

Gjatë vlerësimit dhe analizimit të pretendimit të OE ankuesit, Paneli Shqyrtues konsideron se ankesa është e bazuar për faktin se në ofertën e OE të rekomanduarit ekziston një listë e përshkrimit të projekteve mirëpo nuk ka datë se kur janë përfunduar projektet, dhe po ashtu referencat nuk kanë shpjegim lidhur me datën e mbarimit të kontratës ose dëshmi më objektive. Megjithatë, Paneli Shqyrtues konsideron se AK gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të tenderëve është dashur që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, duke kërkuar nga OE i rekomanduar dëshmitë/referencat sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Sa i përket pretendimit të OE ankues që ka të bëjë me referenca dhe dëshmitë tjera pas datës së njoftimit për kontratë, Paneli Shqyrtues sqaron se AK përmes kërkesës për sqarime duhet të vërtetoj nëse punët e kryera apo furnizimet janë kryer para datës së publikimit të njoftimit për kontratë duke u bazuar në nenin 72.3 të LPP-së, ku është përcaktuar: *"Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive."*, që në rastin konkret do të thotë se referenca/dëshmitë e lëshuara dëshmojnë se punët janë kryer para datës së fiksuar në dokumentet e tenderit.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konsideron se AK nuk e ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë ekzaminimit, vlerësimi dhe krahasimit të tenderëve të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK Prizren";

1x1 OE "SFINGA"SHPK-Prizren;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.